



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 93 Datë 24 . 11. 2008

MBI

Transaksionin e realizuar brenda aksionerëve të shoqërisë për ndryshimin e pronësisë në kapitalin aksionar në shoqërinë Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Perpali Zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24 . 11.2008, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimin e transaksionit të realizuar ndërmjet dy aksionerëve, pjesëmarrës në shoqërinë Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS, lidhur me ndryshimin mbi pronësinë në kapitalin aksionar të kësaj shoqërie.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, neni 56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” neni 25.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretariatit mbi njoftimin e transaksionit të realizuar ndërmjet dy

aksionerëve në konsorciumin Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS, me seli në Stamboll, e regjistruar me nr 512587 në rregjistrin tregtar të Stambollit dhe që funksionon sipas legjislacionit turk

V Ë R E N S E:

- 1** Konsorciumi Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS, është shoqëri aksionere që ka në pronësi 60% të kapitalit në Bankën Kombëtare Turke.
- 2** Kapitali aksionar i Konsorciumit Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS zotërohet nga 3 aksionerë me këtë pjesëmarrje:
 - Shoqëria Calik Holding AS- 42%
 - Shoqëria SekerBank TAS - 34%
 - Shoqëria Calik Yatirim Bankasi 24%

Negociatat ndërmjet dy prej aksionerëve brenda Konsorciumit, për ndryshimin e pronësisë mbi aksionet kanë përfunduar në datën 26 Shtator, me nënshkrimin e “Deklaratës për Shitje”, ku palët pjesëmarrëse në transaksion premtojnë ndryshimin në kapitalin e shoqërisë, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve. Transaksioni do të realizohet me nënshkrimin e një marrëveshje shitblerje në datën 25 Nëntor 2008, me objekt: shitjen e të gjithë kapitalit aksionar prej 34% në zotërim të shoqërisë Seker Bank T.A.S tek shoqëria Calik Holding AS.

- 3** Transaksioni ndodh brenda Konsorciumit, ku shoqëria Calik Holding fiton kontrollin duke rritur pjesëmarrjen në masën 76% të kapitalit aksionar, pra kemi të bëjmë me ndryshim aksionaresh.
- 4** Fitimi i kontrollit nga një aksioner, brenda Konsorciumit Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS, nuk sjell asnjë asnjë pasojë në ndryshimin e kontrollit as direkt dhe as indirekt në Bankën Kombëtare Tregtare, ku Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS zotëron 60% të kapitali.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 25 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”

VENDOSI:

1. Të mos klasifikojë njoftimin “Për ndryshimin e pronësisë në kapitalin aksionar të Konsorciumit Calik-Seker Konsorsiyum Yatirim AS”, si përqendrim në zbatim të neneve 10 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

(_____)
Zv/Kryetar

Servete Gruda

(_____)
Anëtar

Koço Broka

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R